

## RELACION TEKNIK

### **Objekti: Rikonstruksioni i godinës së arkivës së ARRSH-së, pranë drejtorisë së Rajonit Qendror Tiranë**

Me fondet e buxhetit të shtetit për vitin 2023 është parashikuar të rikonstruksioni i ndërtesës ku ruhen dokumentat arkivore të ish Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (sot ARRSH).

Ndërtesa ndodhet brenda territorit të Drejtorisë së Rajonit Qendror Tiranë në vartësi të ARRSH-së. Kjo ndërtesë është me dy kate. Gjendja teknike e kësaj ndërtese paraqitet e amortizuar duke filluar nga taraca, rrjeti elektrik, suvatimet e brendshme, shtresat e dyshemesë, dyer dhe dritare, tualetet, shkallët dhe oborri.

Ndërhyrja konsiston në punimet e prishjes së hidroizolimit, suvatimit, mureve të brendshëm, shtresat e pllakave të dyshemesë, në heqjen dhe çmontimin e dyerve dhe dritareve, zgarave metalike, prishjen e bazamakëve të shkallëve, parapetit të tyre, prishjen e instalimeve elektrike dhe hidraulike në nyjen sanitare.

Më pas do realizohen punimet e hidroizolimit të taracës, së bashku me kasetat dhe ulluqet e shkarkimit. Do të vijohet me punimet e insalimeve elektrike dhe hidraulike.

Do të bëhet rindërtimi i mureve të brendshme me tulla me bira. Gjithashtu do të punohet për realizimin e shtresave të reja të dyshemesë

Do të suvatohet ndërtesa nga brenda dhe do të patinohet dhe lyhet me bojë hidroplastike.

Në punimet e fasadës janë parashikur të realizohen veshja me sistem kapot e godinës, vendosja e zgarave metalike e dyerve dhe dritareve, mbulimi i shkallëve me panele sandwich dhe vendosja e tendave në hyrjet e garazheve.

Objekti do të plotësohet me sistemin e mbrojtjes nga zjarri, rrejtin kompjuterik dhe telefonik dhe sistemin e kondicionimit.

Në përgjithësi në objekt do të realizohen të gjithë zërat e parashikuara në preventiv në përputhje me Kushtet Teknike të Zbatimit.

Grupi i Punës: